



QKLL 2025

MARS



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

28-30 MARS – HAPET PANAIRI NDËRKOMBËTAR I LIBRIT NË LEIPZIG TË GJERMANISË

NË STENDËN SHQIPTARE PANEL DISKUTIMI MBI NJË ROMAN TË KADARESË



11 MARS 2025 / “GJYSMA TJETËR E QIELLIT”, ANTOLOGJIA ME 160 POETË TË LETËRSISË GREKE

“Gjysma tjetër e qiellit”, antologjia me 160 poetë të letërsisë greke, bëri bashkë autorë, përkthyes, njerëz të kulturës për të folur për vlerat e mëdha të kulturës greke. Nën përkthimin e Maklena Nikës kjo vepër është një udhëtim në lirizmin e madh të poezisë.



10 MARS 2025 / FORUMI I GRAVE FRANKOFONE TË SHQIPËRISË. NATË LEXIMI - “ZËRA FEMËRORE HOMAZH I HISTORIVE FRYMËZUESE DHE PASURISË SHPIRTËRORE FEMËRORE”

U mbajt në Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit një mbrëmje letrare e cila u quajt edhe natë leximi, mes grave e vajzave frankofone. Nën drejtimin e dekanes së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Esmeralda Kromidha u morën si shembuj letrarë të kësaj mbrëmjeje 3 vepra të mirënjohura të letërsisë bashkëkohore frankofone.



21 mars 2025 / Në ditën e poezisë, me poeten e njohur franceze **LAURE CAMBAU: KULTURA, MISTICIZMI, RELIGJIONI**



7 mars 2025 / Shpallen kandidaturat e çmimit “LUMO SKËNDO”



5 mars 2025 / Përrurohet libri “PISA - TESTE PËR SHKENCËN”, të autorëve **ET'HEM RUKA** dhe **MARENGLEN SPIRO**



8 mars 2025 / Në ditën ndërkombëtare të gruas – **ME AUTOREN E LIBRIT “RREGULL PAS RREGULLI”, ESTER GJIK**





QKLL 2025

MARS



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

28-30 MARS – HAPET PANAIRI NDËRKOMBËTAR I LIBRIT NË LEIPZIG TË GJERMANISË

NË STENDËN SHQIPTARE PANEL DISKUTIMI MBI NJË ROMAN TË KADARESË

Nën moton “Fjalët lëvizin botën”, Panairi i Librit në Leipzig të Gjermanisë çeli siparin me pjesëmarrjen e mijëra vizitorëve. Shqipëria kishte stendën e saj në hapësirën e Tradukit, ku u prezantuan botimet shqipe.

Stenda e Shqipërisë u vizitua nga ministri për Kulturë dhe Shoqëri të Liechtenstein z. Manuel Frick.

Falë programeve të përbashkëta mes Traduki-t dhe MEKI-t, letërsia shqipe është më e pranishme në gjuhën gjermane mes përkthimeve të ndryshme.

Panaire të këtij lloji në Europë, ku bëhen bashkë lexues, autorë, përkthyes, shtëpi botuese e kritikë letrarë, mbërrijnë edhe si formë komunikimi mes kulturave të ndryshme dhe si mundësi prezantimi për t’u përcjellë letërsia shqipe në disa gjuhë të botës.

Autorët shqiptarë Elvin Nuri, Flogerta Krypi dhe Mimoza Ahmeti u bënë pjesë e një takimi me temën “Fjalë, Fjalë, Fjalë”, i cili tërhoqi vëmendjen e lexuesve.

Fjala ka qenë dhe mbetet një nga fuqitë më të mëdha të njerëzimit. Ajo ka ndërtuar qytetërime, ka ndezur revolucione, ka frymëzuar mendje të mëdha dhe ka lidhur

zemrat e njerëzve për shekuj me radhë. Sot, në këtë epokë të teknologjisë dhe ndryshimeve të shpejta, ne duhet të pyesim veten: Cila është e ardhmja e fjalës? A do të mbetet ajo po aq e fuqishme si dikur, apo po përballemi me sfida të reja që mund ta ndryshojnë përgjithmonë mënyrën se si komunikojmë?

Flogerta Krypi, fituese e Fondit të Krijimtarisë Letrare për të Rinj 2022 nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, mbajti një takim në stendën e Tradukit për romanin e saj “28 rrahje zemre matematikore”, i cili është botuar edhe në gjuhën gjermane.

Të shumtë ishin ata që shfaqën interes për këtë roman dhe ndoqën me kërshtëri takimin.

Ditën tjetër, u zhvillua aktiviteti me temë “Letërsia dhe gjeopolitika” mbi përkthimin në gjermanisht të romanit “Kur sunduesit grinden” nga Ismail Kadare. Në panel ishin Joachim Rohm, Adia Sakiqi, Mimoza Ahmeti si dhe përkthyesja Loreta Schillock.

“Kur sunduesit grinden” është vepra e shkrimtarit më të njohur shqiptar, Ismail Kadare, i

përkthyer së fundmi në gjermanisht. Në qershor të vitit 1934, Joseph Stalin dyshohet se i telefonoi romancierit dhe poetit të famshëm Boris Pastërnak për të diskutuar arrestimin e poetit tjetër sovjetik Osip Mandelstam. Në një ndërthurje magjepsëse ëndrrash dhe faktesh dosjesh. Ismail Kadare, fituesi i çmimit “International Booker Prize”, rindërton tre minutat që folën dhe pasgoditjet e këtij momenti të tensionuar, misterioz në historinë moderne. Duke ndërthurur së bashku rrëfimet e dëshmitarëve, reporterëve dhe shkrimtarëve si Isaiah Berlin dhe Anna Akhmatova, Kadare tregon një histori magjepsëse të pushtetit dhe strukturave politike, të marrëdhënieve midis shkrimtarëve dhe tiranisë.

Në këtë tryezë, u diskutua mbi vendin e Kadare në letërsinë botërore, mënyrën se si veprat e tij trajtojnë temat e pushtetit, historisë dhe lirisë, si dhe rolin e tij si një urë lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit.





QKLL 2025

MARS



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

11 MARS 2025 / “GJYSMA TJETËR E QIELLIT”, ANTOLOGJIA ME 160 POETË TË LETËRSISË GREKE

“Gjysma tjetër e qiellit”, antologjia me 160 poetë të letërsisë greke, bëri bashkë autorë, përkthyes, njerëz të kulturës për të folur për vlerat e mëdha të kulturës greke. Nën përkthimin e Maklena Nikës kjo vepër është një udhëtim në lirizmin e madh të poezisë.



10 MARS 2025 / Forumi i grave frankofone të Shqipërisë. NATË LEXIMI - “ZËRA FEMËRORE ... Homazh i historive frymëzuese dhe pasurisë shpirtërore femërore”

Nata e leximit “Zërat e grave”
Histori frymëzuese dhe trashëgimi për të festuar

U mbajt në Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit një mbrëmje letrare e cila u quajt edhe natë leximi, mes grave e vajzave frankofone. Nën drejtimin e dekanes së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Esmeralda Kromidha u morën si shembuj letrarë të kësaj mbrëmjeje 3 vepra të mirënjohura të letërsisë bashkëkohore frankofone.

Zonja Kromidha vlerësoi se, këto romane, edhe pse vijnë nga kontekste të ndryshme kulturore, ilustrojnë realitete universale: kërkimin për fuqizim, luftën kundër padrejtësisë dhe qëndrueshmërinë e grave. Ato ofrojnë një reflektim përkatës për 8 Marsin, Ditën Ndërkombëtare të Drejtave të Grave, ndërsa theksojnë larminë e zërave frëngjishtfolës.

Romani “Si nesër” nga Faiza Guène, botuar në vitin 2004, është një roman emblematic i letërsisë bashkëkohore urbane. Nëpërmjet zërit të gjallë dhe të paprekur të Doria, një adoleshente me origjinë marokene që jeton në periferitë pariziene, Faiza Guène trajton temat universale si përjashtimi social, identiteti kulturor dhe sfidat që lidhen me adoleshencën. Romani, i sjellë me humor dhe qëndrueshmëri, zbërthen stereotipet që lidhen me të rinjtë nga emigracioni, ndërsa ofron një vështrim mbi realitetet e jetës së përditshme.

Ndërkaq romani “Të paduruarit” i Djaili Amadou Amal, Fituese e çmimit Goncourt des Lycéens 2020, zhytet në zemër të realiteteve të grave kamerunase që përballen me dhunë në familje dhe martesë të detyruara. Përmes zërave të tre grave – Ramla, Hindu

dhe Safira – autori nxjerr në pah padrejtësinë e patriarkatit dhe vuajtjet e heshtura të grave në një kontekst ku traditat mbizotërojnë mbi të drejtat individuale. Ky roman pikant fton reflektim mbi pabarazinë gjinore dhe gjendjen femërore në disa shoqëri bashkëkohore.

Libri i tretë “Eleganca e Iriqit” e autores Muriel Barbery, është një sukses për gratë nga përsosmëria. Sukses i padiskutueshëm dhe i qëndrueshëm i autores, por edhe një festë e bukurisë së brendshme të dy mendjeve të bukura Renée dhe Paloma, dy zëra femrash që përbëjnë një kanun. Puna është një lavd i inteligjencës dhe rafinimit të një gruaje të thjeshtë por edhe një himn i vërtetë për jetën dhe bukurinë.





QKLL 2025

MARS



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

21 MARS 2025 / Në ditën e poezisë, me poeten e njohur franceze **LAURE CAMBAU**: KULTURA, MISTICIZMI, RELIGJIONI



Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit organizoi aktivitetin me temë: "Kultura, misticizmi, religjioni", ku e pranishme ishte poetja franceze, Laure Cambau. Në mjediset e QKLL, Cambau bashkëbisedoi mbi temën me poeten Mimoza Ahmeti, në këtë

aktivitet i cili përkoi me Ditën Ndërkombëtare të Poezisë. Poeteshat lexuan pjesë nga vëllimi poetik "E bardha pa të bardhë" i Laure Cambau, libër i cili është përkthyer në shqip dhe i pajisur me shënime nga Luan Rama. Ky vëllim poetik i kushtohet piktorit shqiptaro-francez Omer Kaleshi. Poetja e ftuar nga QKLL, Laure Cambau, jeton në Paris. Poete dhe pianiste, ajo është gjithashtu autore e tregimeve për fëmijë dhe e teksteve të këngëve. Cambau ka botuar dhjetë përmbledhe me poezi dhe ka marrë çmimin Poncetton të SGDL për Lettres au voyou céleste (Amandier, 2010). Veprat e saj të fundit përfshijnë "La fille peinte en bleu" (Caractères/Ecrits des Forges, Quebec) dhe "Ma peau ne protège que vous" (Le Castor Astral). Në vitin 2017 u botua Le

"Manteau rapiécé, un voyage au fil du souffle (Unicité)", një libër i frymëzuar nga takimi i saj – shpirtëror dhe i përkohshëm – me bektashinjtë ("kushërinjtë" e sufijnve); ky libër mori çmimin Vénus Khoury-Ghata 2018. Koleksioni i saj, "Grand Motel du Biotope" u botua nga APIC (Algiers) më 2021 dhe ishte finaliste për çmimet "Apollinaire" dhe "Mallarmé" dhe mori çmimin "Léon Paul Fargue" në 2022 në Paris. Në vitin 2023 ajo botoi "Les Yeux de la Mouche (Le Castor Astral)" dhe ishte gjithashtu finaliste për disa çmime. Ajo është anëtare e Compagnia delle Poete (Mia Lecomte) dhe është një bashkëpunëtare në revistën "Apulée". Ajo performon rregullisht muzikë dhome, me artistë lirikë dhe shkrimtarë.



5 MARS 2025 / Përrurohet libri "**PISA - TESTE PËR SHKENCËN**", TË AUTORËVE **ET'HEM RUKA** DHE **MARENGLEN SPIRO**

U përurua në mjediset e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit libri "Pisa - Teste për shkencën", të autorëve Et'hem Ruka dhe Marenglen Spiro. Profesorët E. Ruka dhe M. Spiro, bashkautorë të këtij botimi, vlerësuan këtë vepër me karakter didaktik, lidhur me testet dhe përpilimin e tyre, brenda programit të Pisa-s, një program ndër-kombëtar vlerësimi për fëmijët 15-vjeçarë në shkencë, matematikë dhe lexim.

Ky program ka startuar që në vitin 2000 dhe mbahet çdo tre vjet, dhe vlen për unifikimin e vlerësimit të programeve tona mësimore me ato ndërkombëtare. Profesor Ruka nënvizoi rëndësinë e këtij botimi, me teste të prodhuara nga vetë ne, ndërsa deri tani janë përdorur teste të përkthyer nga jashtë. Teste të tilla duhet të shërbejnë për vetëvlerësimin e nxënësve nga shkollat dhe mësuesit, madje duhet të nisin që në muajin prill të këtij viti.



QKLL 2025

MARS



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

Akademiku Spiro e quajti botimin një punë të vogël në shërbim të shkollës, që vendi ynë të renditet sa më mirë në rang ndërkombëtar. Sipas tij, përmbledhja e tre autorëve është e arrirë për mjedisin shkollor shqiptar dhe nivelin e nxënësve. Edhe pse testet që

janë botuar, nuk janë pjesë e kurrikulave shkollore, duhet nxitje që ato të arrihen shpejt. Botimi përmbledh teste mësimore në biologji, fizikë, shkencat e tokës dhe kimi.



6 MARS 2025 / “FONDI I PËRKTHIMIT LETRAR NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHË TË HUAJ”, THIRRJE PËR VITIN 2025



Libri “Vallëzim me hënën” i shkrimtarit Namik Dokle është përkthyer në gjuhën spanjolle me mbështetjen e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit falë “Fondit të Përkthimit Letrar nga Gjuha Shqipe në Gjuhë të Huaj”, një fond i përvitshëm nga QKLL.

Në këtë libër përfshihen 52 legjendat e Gorës, zonave të vendlindjes së tij duke zgjuar vlerat kulturore e shpirtërore të kësaj zone.

“Fondi i përkthimit letrar nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj”, është hapur edhe këtë vit, që prej 1 marsit dhe data e fundit e aplikimeve është 31 mars 2025. Kjo thirrje u drejtohet gjithë botuesve të huaj që duan të botojnë në gjuhët e tyre autorë shqiptarë.

Ndaj ftojme të gjithë botuesit e huaj që të aplikojnë brenda këtij afati për të bërë pjesë të skenës së tyre letrare edhe kulturën shqiptare.

12 MARS 2025 / ZGJIDHET JURIA E “FONDIT TË PËRKTHIMIT LETRAR NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHË TË HUAJ”



Përkthyesi **Erion Kristo**, përkthyesja **Maklena Nika** dhe studiuesi **Ben Andoni** përbëjnë jurinë e “Fondit të përkthimit letrar nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj”, i çelur nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në mbështetje të autorëve shqiptarë, si dhe përkthimit e promovimit të veprave të tyre jashtë Shqipërisë. Ju kujtojmë se aplikimet për këtë thirrje janë të hapura deri më datë 31 mars 2025.

Për më shumë detaje, klikoni në linkun e mëposhtëm: <https://qkll.gov.al/?p=11180> #qkll #ministriaekonomisekulturesdheinovacionit #përkthimi



QKLL 2025

MARS



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

7 MARS 2025 / SHPALLEN KANDIDATURAT E ÇMIMIT “LUMO SKËNDO”



Ju njohim me 10 kandidatët për Çmimin Lumo Skëndo:

Finalistët:

Sherif Bundo – “Dollia shqiptare”, Botimet MediaPrint

Arben Imami – “Kushtetuta”, UET Press

Vjola Isufaj – “Baladë dritash për Zorbën”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Luan Rama – “Udha e gjatë në tunelin e Platonit”, botimet Albas

Bedri Islami – “Kadare i oborrit apo i lirisë”, UET Press

Enis Sulstarova – “Samiu dhe Utopia”, Pika pa Sipërfaqe

Stefan Çapaliku – “Post Scriptum – Studime kulturore”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Rexhep Qosja – “Për lirinë, të vërtetën dhe të drejtën”, botimet Toena

Pirro Loli – “Unë jam një tjetër”, botimet Ada

Edlira Çerkezi – “Mitet dhe raporti me letërsinë artistike”, botimet Maluka

8 MARS 2025 / NË DITËN NDËRKOMBËTARE TË GRUAS – ME AUTOREN E LIBRIT “RREGULL PAS RREGULLI”, ESTER GJIKA

Në Ditën Ndërkombëtare të gruas, autorja Ester Gjika solli për lexuesin librin “Rregull pas rregulli”, një leksion mbi feminizmin. Regjisori Pirro Milkani, Avokatja e Popullit Erinda Ballanca dhe botuesja Irena Toçi, ndanë perceptimet e tyre mbi këtë botim me vlera.

Libri është një himn thurur gruas, në tërësinë e saj, për forcën, për burimet e pashtershme dhe të jashtëzakonshme, për aftësitë dhe karakterin e paepur, për temperamentin e saj të vrullshëm, po aq edhe të butë, për botën e pafundme të gruas dhe ndihmesën e saj të

paçmuar në familje dhe në shoqëri. Është një elozh dhe lavdërim i sinqertë dhe i ndier thellë i vetëpranimit, autencitetit, natyrshmërisë, i të qenit krenare ashtu siç jemi, pa filtra, pa ndryshime, pa manipulime imazhi!





QKLL 2025

MARS



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

20 MARS 2025 / AKTIVITET PËR POEZINË E AUTORIT FATMIR MUSAI

Pjesëmarrësit e shumtë në këtë aktivitet ngritën lartë figurën e poetit dhe ciklet e tij poetike.

Sipas poetit Aleksandër Çipa, poezia e Musait është e angazhuar, qytetare dhe me lirizëm të spikatur.

Prezantuesja Silvana Braçe nënvizoi tematikat e larmishme të poezisë së këtij autori, vargun e rrjedhshëm e rimat e ndryshme.

Shkrimtari Namik Dokle theksoi humorin e hollë, përsiatjet e bukura dhe gjuhën lakonike të përdorur nga Fatmir Musai në vargjet e tij. Ai u shpreh se në vargje Fatmiri tallet me të keqen.

Të pranishmit e shumtë kujtuan vargjet e hershme të poetit që në vitet '70, të cilat janë pasuruar në figura e gjuhën e përpunuar.

Vetë Musai, i quajtur edhe rebel nga miqtë, kujtoi se ka krijuar në jetën e tij 2525 poezi, një numër tej hamendjes edhe të vetë atij. Falënderoi të gjithë për vlerësimet e dhëna rreth vargut të tij, që mishëron këdo personazh, apo çfarëdo ngjarje dhe përjetim.



15 MARS 2025 / TAKIM ME AUTORIN REZART PALLUQI NË PREZANTIMIN E LIBRIT TË TIJ "SHTËPIA ME DY ÇATI"

U përurua në mjediset e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit romani "Shtëpia me dy çati" i autorit Rezart Palluqi.

Romani "Shtëpia me dy çati" është vepra letrare e autorit Rezart Palluqi, botuar nga shtëpia botuese "2 lindje & 2 përëndime".

Historiani Xhafer Sadiku e vlerësoi romanin për vetë tematikën që mbart, pra përplasjen e egër midis botës helene dhe asaj bizantine, e cila mohon gjenocidin çam.

Romani gjithashtu u vlerësua edhe nga autori e kritiku Ahmet Mehmeti dhe studiuesi Behar Gjoka, të cilët i

mëshuan fort faktit që ky libër na ballafaqon me problemet psikosociale dhe shpirtërore të qenies njerëzore.

Ky roman është fitues i çmimit "Azem Shkreli" në Gjermani.

